

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **K.K. SKENDERAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **643-25-1360-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **007 - Mirëmbajtja dhe servisimi për ngrohje, ftohje, ventilim dhe klimatizim në Objektin e Komunës, Shtëpinë e Kulturës, Palestrën Sportive, QKMF-së, AMF-të në bashkësi lokale, SHPMPF dhe objekti i QPS-së në Skenderaj.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	GREEN INSTALL SH.P.K.
NUI	811279860
Adresa	Nabergjan
Vendi	nabergjan
Kodi postar	30000
Numri Telefonit	049270433
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	shaban dreshaj
Adresa elektronike	greeninstall@yahoo.com
Data e parashtrimit të ankesës	07.05.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

007 - Mirëmbajtja dhe servisi për ngrohje, ftohje, ventilim dhe klimatizim në Objektin e Komunës, Shtëpinë e Kulturës, Palestrën Sportive, QKMF-së, AMF-të në bashkësi lokale, SHPMF dhe objekti i QPS-së në Skenderaj.

Njoftimi për kontratë: 03.03.2025

Hapja e ofertave date:01.04.2025

B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK: 25.04.2025

Kërkesa për qasje: 26.04.2025

Lejmi i qasjes: 28.04.2025

↪Kërkesa për rishqyrtim, date: 30.03.2025

Përgjigje e KPR-së 06.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Refuzohet e pabazuar- vendimi i dates 05.05.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

K.K. SKENDERAJ-ka shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si në vijim:

Neni 1 të LPP-së

Neni 2 të LPP-së

Neni 6 të LPP-së

Neni 7 të LPP-së

Neni 24 të LPP-së

Neni 52 të LPP-së.

Neni 56 të LPP-së.

Neni 59 të LPP-së

Neni 60 par. 1.1 të LPP-së.

Neni 40.6; 40.7 dhe 40.12; 40.13 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP – Versioni i korigjuar

Neni 45.19; 40.20; 45.21 dhe 45.22 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP – Versioni i korigjuar

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK – **KOMUNA SKENDERAJ**, me datë **25.04.2025**, përmes platformës elektronike e-prokurimka publikuar në platformën elektronike e-prokurim- B58 Njoftimi mbi vendimin e AK, për këtë aktivitet të prokurimit, që do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, dhe rreg. Nr. 001/2022 për PP version i korigjuar, të cilat

do i argumentoj dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkrësisht në vazhdim të kësaj KpR.

-

Andaj duke marr për baze dispozitat ligjore të **nenin 4 të LPP-se, ne si OE me pale me interese sipas nenit 4 par. 1.26 të LPP-se,** edhe për kunder faktit se ne kemi arritur të plotësojm të gjitha kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, mirëpo AK – Komisioni i vlerësimit – ZPP duke shkelur dispozitat ligjore të LPP, duke na eliminuar padrejtësisht, duke na diskriminuar ne po detyrohemi të parashtrojm **Kerkese per Rishqyrtim** pranë AK duke pasqyruar faktet dhe argumentet lidhur me **DEKLARATEN NËN BETIM; Listen e Kontratave dhe Referencave; si dhe ISO 50001:2018 dhe Specifikimin teknik, të detyrueshem – Aneksi 1 I FDT-se,** të cilat i kemi dorëzuar në platformen elektronike e-prokurim për këtë AK me rastin e aplikimit ku argumentohet dhe konstatohet se të gjitha dokumentacionet e kërkuara për këtë AP janë në pajtim të plotë me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë – duke plotësuar në tërësi kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesorë të dhënies së kontratës – **çmimi me i ulet i përgjegjshëm.**

AK me rastin e eliminimit të kompanisë tonë për aktivitetin e prokurimit përmes njoftimit B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK –për këtë aktivitet të prokurimit duke na shpallur si Të ELIMINUAR (pa përgjegjshëm). Ne tani po nisim disa pretendime tatimore dhe disa arsyetime konstatime në këtë AP – Procedurë të Prokurimit , si më poshtë:

-

Autoriteti kontraktues – komisioni i vlerësimit – ZPP në komunën e Skenderajit, me rastin e eliminimit të B42 – letrës standarde të eliminimit të datës: **25.04.2025, në shkelje të nenit 59 dhe 60-të LPP-së dhe nenit 45 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP,(Krejt kjo është bërë duke na diskriminuar** duke dhënë arsyetime të cilat nuk kanë bazë ligjore, fakte konkrete sikurse ne vijim po citojmë:

AK me rastin e vlerësimit. Ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve në letren standarde të eliminimit ka përshkruar dhe ka dhënë disa arsyetime të cilat nuk qendrojnë dhe kanë mbështetje ligjore, mirëpo AK – ZPP mundohet të jep një përshkrim ,sigurisht pa konsultuar me antarët e vlerësimit sepse nga përshkrimi i arsyetimeve të eliminimit vërehet lehtë se këto e ka bërë ZPP dhe jo komisioni i vlerësimit duke mos dhënë asnjë provë me fakte dhe argumente por vetëm duke përshkruar dhe duke u ftuar në ndonjë dispozitë ligjore që i mbështet këto përshkrime që nuk kanë fakte dhe argumente konkrete. Ne i rikujtojm AK – ZPP dhe Komisionit të vlerësimit, se vlerësimi i tenderëve duhet të bëhet në pajtim të plotë me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së dhe jo të jep përshkrim dhe të ftohet në supozime dhe të jep kahje krejtësisht tjetër duke mos marr për baze kriteret e përzgjedhjes por të ftohet në disa gabime tërësisht minore dhe që nuk kanë asnjë ndikim në qëllimin e prokurimit dhe ekzekutimin e këtij AP edhe për kundër që ne jemi pajtuar dhe kemi arritur të plotësojmë të gjitha në shumicë në pajtim me nenin 59 dhe 60 të LPP-se ne jemi GOE të përgjegjshëm. Mirëpo AK me

vetëdije dhe qëllim të caktuar na eliminon padrejtësisht dhe duke na diskriminuar vetëm e vetëm për të rekomanduar OE të preferuar dhe të cilet janë dukshëm me cmime më të larta se sa oferta jonë, dhe të cilet nuk janë të specializuar për kryerjen e punëve furnizimeve për këtë natyrë të këtij AP, por do të kontraktot tek OE të cilet janë të specializuar për natyrën e këtyre punëve të kësaj dhe demonstroi edhe cmimi i lartë mbi tregun ku ka dhënë ky OE i rekomanduar nga AK – ZPP duke demtuar edhe buxhetin e Komunes dhe Republikës së Kosovës duke shkelur parimin e prokurimit vlerë për cmim dhe qëllimin e prokurimit.

Andaj në vijim po theksojmë arsyetimin e eliminimit në letrën standarde të eliminimit të datës 24.03.2025 që kemi pranuar përmes platformës elektronike e-prokurim si në vijim:

Lusim të analizoni dhe shikoni - B42 – Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar të datës: 25.04.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi për këtë AP, ku përmend piket e eliminimit

DEKLARATËN NEN BETIM;

Listen eKontratave

Listen e Referencave;

ISO 50001:2018

Specifikimin teknik, të detyrueshem – Aneksi 1 I FDT-se

1.Këto arsyeime të shkruara në letrën standarde të eliminimit – B42 nga **AK – ZPPkomisioni i VLERESIMIT nuk qendrojnë për faktin** sepse ne me rastin e ofertimit/tenderimit në platformën elektronike e-prokurim kemi dorëzuar Deklaruar kontratën nën Betim të nënshkruar dhe të vëlosur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të LPP-se, konkretisht nën 65 të LPP-se, për faktin se në këtë deklaratë shkruan qartë **Titull i prokurimit** në **“Footer”**, ndërsa në **“Header”** shkruan **“B15 Dosja e tenderit” – Shërbime procedure e hapur** me numër rendor “17”, në vend se të jete: **“B28_Ng Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë – Shërbim Me Disa OE”**, me numër “22”

Keto devijime të vogla që nuk kanë asnjë ndikim në aspektin ligjor të nën 65 , po ashtu edhe në 1% qëllimin dhe fushën e këtij aktiviteti të prokurimit për faktin

se ne kemi dorëzuar tender permes platformes elektronike e-prokurim ku jemi të regjistruar dhe këtë deshmon edhe procesverbali i hapjes dhe platforma elektronike e-prokurim dhe këto të dhëna të mbetura ne “Header” nuk kanë asnjë rendësi dhe ndikim apo që duhet të bejë tenderin tonë të “Papapërgjegjshëm” sepse kjo është vetëm devijim i vogël që nuk ndikon në materien dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit ashtu sic mundohet ZPP të elaboroj dhe pershkruaj e arsytoj se kinse ne kemi dhënë deklarat për një procedurë tjetër dhe jo për këtë aktivitet të prokurimit, kur dihet shumë qartë dhe konstatohet se ne kemi dorëzuar oferte pikërisht për këtë AP me titull dhe numër të prokurimit, që deshmon se ne kemi plotësuar kërkesat sipas NENIT 65 të LPP-se sipas formes në Aneksin 2 të Dosjes së Tenderit, pervec se ne “Footer”, dhe “Header” kemi plotësuar titullin, dhe me rastin e pergatitjes së kësaj Deklarate gabimisht ka mbetur përshkrim “B15 Dosja e tenderit” – Sherbime procedure e hapur” që do të thotë dhe deshmon se ne kemi plotësuar kërkesat e nenit 65 të LPP-se dhe jemi të vetëdijëshëm për këto kërkesa dhe do të mbajmë përgjegjësi dhe sigurojmë AK se jemi në përputhje me kërkesat e nenit 65 të LPP-se, dhe përshkrim në “Header” është devijimi vogël dhe qenuk e prek aspak “apektin material” të Tenderit ashtu sic e rregullon nenet 45.19, 45.20 dhe 45.21 të Rregullore nr. 001/2022 per PP – version i korigjuar. Prandaj marr për bazë këto fakte dhe argumente AK – ZPP dhe Komisioni i vlerësimit kanë qënë të detyruar të trajtojnë këtë devijim të vogël që nuk e prek materien e prokurimit – apsketin material dhe është krejtësisht devijim i vogël që nuk do të ndikoj apo ndryshoj asnjë element apo qëllim dhe pikat që mbulohen sipas nenit 65 të LPP-se.

Me fjalë tjera ne besojmë se AK do të reflektojë dhe të veprojë në pajtim të plotë r qeshtje dhe këtë gabim apo devijim që nuk është përmbajtësor dhe nuk prek aspak aspe këtij prokurimi apo të këtij aktiviteti të prokurimit, duke e trajtuar si devijim të vogël dëmin që po i shkakton AK pasi që ne kemi tenderuar me çmimin shumë më të lirë se ZPP është në shkelje të nenit 7 të LPP-se dhe parimit kryesor të prokurimit “vlera

2. Lista e kontratave edhe Referencave ne me rastin e tenderimit nuk kemi dorëzuar listën e kontratave të kryera dhe referencave të punës së kryerë duke plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nën 9.1 & 9.2 të LPP-se.

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë- në vlerën minimale prej 100,000.00 euro.

Evidenca 1. Lista e kontratave të natyrës së ngjashme të publikimit të njoftimit referencave të punës së kryerë pranimeve në vlerë

Duke marr për bazë se edhe përkundër se nuk kemi prezantuar një **LISTE Të KONTRATAVE** – ne si OE kemi ofruar deshmim me fakte dhe prova konkrete ku kemi dorezuar Disa Referenca si në vijim:

Referenca leshuar nga PROEX Shpk në vlerë financiare: 110,200.00 €

Referenca leshuar nga ATC COM Shpk në vlerë financiare: 63,000.00 €

Referenca leshuar nga ATC COM Shpk në vlerë financiare: 107,000.00 € ku specifikon Titullin: Implementatin of EE Measures for 55 Sub-Projects (lot 2) KEEF/1A1/W/2021 – 2022- 2023

Ku specifikon se ku janë ekzekutuar: Komuna e Malisheves 25,780.00 €, Mitrovica 32,650.00 €, Komuna e malisheves (Implementation of EE Measures for 10 Sub-Projects – KEEF/1A3/W/2022 – 2023) Komuna e Malisheves 27,250.00 €, dhe Komuna e Istogut 21,820.00 €, që në total i bie: **107,500.00 €**

Referenca leshuar nga N.N. “Vala” me numer prokurimi: 33600-23-1549-5-2-1 dhe titull: Renovimi brendshëm i bllokut 2 në Qendren Korrektues në Dubrave në vlerë: **42,723.80 €**

Me vetë faktin se ne kemi dorezuar keto referenca me rastin e tenderimit për kete AP në platformën elektronike e-prokurim të cilat deshmojn periudhën kohore të realizuar, në vendin dhe vlerën e projektit, edhe përkundër se nuk kemi dorezuar “Listën e Kontratave të realizuara”, ne cilesinë operatorit ekonomik kemi arritur të plotësojmë në tërësi kërkesën e Dosjes së Tenderit të cituar më lartë.

Ne konsiderojmë se edhe përkundër se nuk kemi prezantuar listë të kontratave, “**ku nuk ka qënë kërkesë që kjo listë të jetë e nënshkruar dhe vëlosur nga OE**” nëse i referohemi **“evidence 1.”** Ku thotë: “Listat e kontratave të realizuara (përfunduara) të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të bashkangjitura me kopje të referencave apo certifikatave, raporteve të pranimeve në vlerën e kërkuar.”

Pra me fjalë tjera sikur të ishte kërkesë që kjo listë të jetë e nënshkruar dhe e vëlosur ne do të ishim të papërgjegjshëm dhe sigurisht nuk do të parashtojmë KpR, por sipas EVIDENCES 1 nuk është kërkuar që të jetë e nënshkruar dhe e vëlosur, prandaj marr për bazë faktin se ne kemi dorezuar – bashkangjitur kopje të **“Referencave”** të cilat e plotësojnë në tërësi vlerën prej 100,000.00 €, atëherë AK – ZPP – Komisioni i vlerësimit është dashur të veproj sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së, të trajtoj se devijim që nuk prek aspektin material të Tenderit dhe të marr parasysh keto referenca si të mirëqena apo/ose nëse akoma ka dilema tveproj në përputhje me nenin

59.2 dhe 72 te LPP-se, per tusiguruar se ne kemi arritur te realizojmë keto punime te prezantuara permes ketyre referencave!... Po ashtu keto referenca jane leshuar nga OE privat në keto raste nuk ka raport te pranimeve te puneve, por sipas marrëveshjeve tona me OE sipas kushteve te marrveshjes pas ekzekutimit te punimeve leshohen dh e ekzekutimi i pagesave – vlerave fianciare, andaj për këtë pike AK – ZPP – Komisioni i vleresimit eshte dashur te kerkojnë sqarime shtesë dhe mos të na elemniojnë duke u thirrur ne dispozita ligjore sipas UDHËZUESIT NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, me rastin e elemnimit tone permes letres standarde B42

Gjithë ashtu nese i referohemi UDHËZUESIT NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, konkretisht nenit 10. Sqarimi i tenderëv e gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetëm në raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojnë përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, ku në rastin tone tabela ne kete dispozita ligjore e sqaron rastin ne vijim, ku thote decidivisht:

Problemi	Si tëveprohet?	Neni i LPP
Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimet/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese 69	69

Prandaj, marr per baze te gjithë keto fakte dhe argumente si dhe mbeshtetur ne keto dispozita ligjore te LPP-se, AK – ZPP dhe Komisioni vleresimit me rastin e elemnimit tone ka shkelur **nenin 1, 7, 59 dhe 72 te LPP-se**, per faktin se perkunder se mungon lista e kontratave ne kemi dorezuar referencat te cilat mbulojn vleren e kerkuar prej: **100,000.00 €**dhe po ashtu mbulojn periudhen kohore prej 3 vite nga data e publikimit te Njoftimit per kontratë, dhe jo të na eliminoj me arsytimin se mungojnë **“Transaksionet perms Bankes”** duke shkelur **nenin 56 par. 3 te LPP-sese** pse nje kerkesë e tille nuk ka qënë

kerkese (kriter i perzgjedhjes) as ne dosjen e tednerit dhe as ne Njoftimin per kontratë,sepse asnje tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e Tenderit, andaj shpresojmë dhe besojmë se AK – ZPP dhe Komisioni i vleresimit te analizojn dhe reflektojn ne gabimin e tyre dhe te aprovojnë kerkesën tone ne menyre qe mos të na detyrojnë te drejtohem i institucioneve relevante, po te na trajton drejt dhe barabartë duke respektuar **nenin 59 dhe 60 te LPP-se**, duke na shpall fitues per faktin se ne jemi OE i pergjegjshem per kete AP. Po ashtu kemi prezantuar edhe Kontraten te cilen e

kemi nenshkuar po me AK – KK Skenderaj ne vitin 2024 per kete natyr te sherbimeve dhe nuk kemi referenc negative per kete kontratë.

3. ISO 50001 : 2018 ne me rastin e tenderimit kemi dorezuar kete ISO standard duke plotesuar ne teresi kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni7.1 &7.2 te FDT-se si ne vijim:

2. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 50001 2018 furnizimi dhe puna e të gjithë sistemit për Ngrohje, Ventilim dhe Klimatizim apo Kondicioner (HVAC).	2. Dëshmia Operatori Ekonomik duhet te jetë i certifikuar me ISO 50001 2018 furnizimi dhe puna e të gjithë sistemit për Ngrohje, Ventilim dhe Klimatizim apo Kondicioner (HVAC). ISO të dorezohet me link verifikimi.
---	--

Nese i referohemi termit HVAC (sipas wekepedia) ka kete kuptim: HVAC – është një akronim për Ngrohje, Ventilim dhe Kondicionim Ajri. Një sistem HVAC përmbane sa është një sistem i plotë komoditet në shtëpi që mund të ngrohë dhe ftohtë shtëpinë tuaj, si dhe të ofrojë cilësitë përmirësuar të ajrit të brendshëm dhe kontroll të lagështisë. Ekzistojnë shumë lloje të ndryshme të sistemeve HVAC.

Nga dëshmia e lart cekur shihet qartë se AK-ja nuk ka dhënë asnjë arsytim për refuzimin ne letren standard te elemnimit qe eshte e bazuar ne ndonje kerkes apo standard apo/ose dispozit ligjore por vetem nje pershkrim I cili eshte tersisht ne kundërshtim me vete kerkesen e percaktuar ne dosjet e tenderit dhe njoftimin per kontrat e ashtu sic kemi specifikuar si me lart. Me fjale tjera AK-ja nuk ka bërë asnjë konstatim të cilit mund ti referohemi dhe te konstatoj se certifikata jone e prezantuar ISO 50001 : 2018 nuk e ploteson kerkesen e dosjes se tenderit dhe njoftimi per kontrate -Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni7.1 &7.2 te FDT-se.

Po ashtu, **HVAC** – standardi yne i prezantuar ne platformen elektronike e-prokurim nga ana jone perfshin Ngrohje, Ventillim, Kondicionim/Klimatizim ajri, qe do te thot e ploteson kerkesen e dosjese se tenderit ne ploteni dhe AK – ZPP – Komisoni ivleresimit pa te drejt dhe ne shkelje te nenit 7 dhe 59 te LPP-se na eliminon pa fakte dhe baze konkret, gje qe ky veprim I AK eshte edhe ne shkelje te nenit 60 te LPP-se.

Në këtë rast e njëjta pasi që nuk ka mundur në asnjë mënyrë të dëshmoj të kundërtën e fakteve dhe prova që kemi dorezuar ne platformen elektronike ISO 50001 : 2018 , ka dhene dhe si arsyetim se: “Kjo certificate eshte nxjerr pas Njoftimit per kontrate” që deshton se AK me kete veprim qellimisht ka shkelur **nenin 7 dhe 59 te LPP-se**, per faktin se kriteret e perzgjedhjes vleresohen nga afati per dorezimin e tendereve dhe jo nga njoftimi per kontrate, sepse ne momentin e dorezimit ne kemi prezantuar certificate valide dhe shume lehte ka mundesi dhe te verifikohet sipas **nenit 52 par. 7 te LPP-se**, mirepo AK qellimishtnaelemnondueknadiskriminuardhe duke shkelurqellimin e prokurimit dhe efikasitetin ashtu sic percaktohet ne **nenin 1 dhe 6 te LPP-se**, per faktin se ne kemi dorezuar tender te pergjegjshem duke plotesuar te gjitha kriteret e perzgjedhjes si dhe kemi tenderuar me cmimin me te ulet te pergjegjshem, duke jap arsytme ne letren sttandarde B42 pa ndonjë arsyetim konkret, por vetem duke jap pershkrim dhe duke u munduar te na bind se ne nuk kem arritur te plotesojm kerkesat e DT dhe NJK. , sepse nëse eventualisht nuk do te plotesonim kriteret e perzgjedhjes, atëherë AK-ja do ta dëshmonte me fakte konkrete një gjë të tillë mirëpo që nuk e ka bërë por vetem ka dhene pershkrim pa fakte dhe prova konkrete.

4.Specifikimi Teknik i Detyrueshem – Aneksi 1 nese I referohemi Dosjes se tenderit si dokumnet themelore per pergaditjen e tendereve nga operatoret ekonomik tecilet shprehin inters te tenderojn ne nje aktivitet te prokurimit, askund nuk specifikohet se OE duhet apo/ose eshte I obliguar te nenshkruaj ANEKSIN 1 te FDT-se, apo/ose te dorezoj ndonje deklarate me shkrim se pajtohet me specifikimin Teknik, andaj ky arsyetim i dhen ne letren standard te elemnimit t eshte ne shkelje te nenit 56 par. 3 te LPP-se, dhe vetem sa per te rritur numrin e arytimeve per elemnimit dhe te bind se kinse ne jemi vertet te pa pergjegjshem?!.....

Po ashtu ju sqarojm se Tabela e prezantuar ne dosjen e tenderit tek specifikimi Teknik - Aneksi 1 eshte identic me tabelen e pershkrimit te cmimeve ne EXCEL, prandaj marr per baze kete fakt dhe argument qe me lehtesi verifikohet dhe konstatohet ne platformen elektronike, atehere duke pas parasysh se kemi vendosur cmimm njesi per secilin pozicion dhe jemi te vetijshem per furnizimet, sherbimet dhe punet qe do te realizohen/ekzekutohen per kontrate dhe me vet faktin se kemi dorezuar tender per kete AP atehere do te thote se ne kemi arrit te plotesojm te gjitha kushtet dhe kriteret e perzgjedhjes per AK ne letren standard B42 eshte jo profesionale me qellim te elemnimit.

Pretendimet ankimore lidhur me OE te rekomanduar per dhenie te kontratës nga AK i cili eshte i papergjegjshem si ne vijim:

Pretendimi 1:

Me rastin e rekomandimit per dhenie te kontrates Besim Recaj B.I. i cili nuk ka arit

te plotesoj kerkesen per qarkullim per kontratë te ngjashme pasi qe nuk arrin te plotesojkerkesen per 100,000.00 € nese analizohet lista e kontratave te perfunduar te ngjashem vlere e realizuar eshte vetem 66,377.00 € qe do te thote se nuk e mbulon vleren e kerkuar tek kapaciteti teknik dhe profesional tek neni 9.1 & 9.2 te FDT-se. Disa nga kontratat dhe referencat e prezantuar jane te viteve pertej periudhes 3 vjeqare nga njoftimi per kontratë. Gjithashtu disa kontratë te prezantuar ne liste nuk jane te ngjashme fare sipas Kodit te fjalorit te prokurimit FFP. Gjithashtu nuk ka deshmuar referenca dhe deshmi se ka realizuar kontratat e prezantuar ne liste. Po ashtu nereferenca nuk specifikohet vlere e realizuar te puneve , sherbimeve apo edhefurnizimeve, andaj keto referenca jane fiktive dhe AK ka qenë i obliguar te kerkoj sqarime dhe te bindet se OE I rekomanduar nuk e ploteson kerkesne e kerkuar te FDT-se dhe NJK, mirepo AK ka shkelur nenit 7 duke favorizuar kete OE si dhe ne shkelje te nenit 59 dhe 60 te LPP-se.

Gjithashtu si prove eshte edhe qarkullimi permes bankes që deshmon se OE nuk e ploteson kete kerkesë pasi qe disa pagesa i ka jashte periudhes 3 vjeqare nga njoftimi per kontratë per kete AP.

Pretendimi 2:

Po ashtu, ISO 5001 : 2018 standardi i Prezantuar nga OE I rekomanduar per dhenie te kontrates nuk mund te gjendet ne linkun e prezantuar me rastin e marrjes se qasjes prandaj AK ka qen dashur te shkruaj ne e-mailin I cili eshte I prezantuar ne kete certifikat sipas nenit 72 te LPP-se, mirepo nje gje te tille nuk e ka bere duke favorer OE te cilin e ka rekomanduar per kontratë sepse ne dyshojm se kjo certifikat eshte fictive dhe nuk ka nje konfirmim nga kompani e cila e ke leshuar kete certifikat, andaj me kete veprim AK ka shkelur nenin 59 dhe 72 te LPP-se, si dhe nenin 60 te LPP-se per faktin se ne kemi dorezuar tender me cmimin me tule ulete dhe kemi plotesuar ne teresi kriteret e perzgjedhjes per kete aktivitet te prokurimit.

Gjithashtu, ne perveq qe kemi tenderuar ne pajtim te plote me te gjitha kriteret e perzgjedhjes te percaktuar ne dosje tenderit, po ashtu duke plotesuar Aneksin 1 me dokumentet relevante dhe deshmi konkret, NE kemi tenderuar edhe me cmimin me te ulet tepergjegjshem duke vendosur cmimin me te ulete se sa OE te rekomanduar per kontrat. Me keteveprim AK – ZPP ka shkelur parimin kryesor te prokurimit **“VLEREN PER PARA”** me rastin e eliminimit tone dhe rekomandimin e GOE per dhenie te kontrate, duke demtur Buxhetin e Komunes dhe te Republikes se Kosovees pasi qe AK na ka eliminuar NE si OE me cmimin me teulet te pergjegjshem

Provë: Pershkrimi i Cmimeve të dorezuara nga ana jone – sidhe Procesverbalit i hapjes.

Ne mbesim me shpresen se AK – ZPP do te reflektojn dhe te shterrin te gjitha mundesit ligjore te cilat jane te parapar me dispozitaligjore te LPP-se, dhe te sigurohen dhe te konstatojn se NE si GOE jemi te pergjegjshem dhe plotesojm kushtet dhe kriteret e dhenies sipas dosjese se tenderit dhe njoftimit per kontrate.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u cekën me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me **nenin 59 LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i pergjegjshem me çmimin me teulet, sipas **nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së**.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe “*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe **nenin 1 te LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosoves.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga ZPP – AK që të shqyrtoj KpR tonë dhe të nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar KpR (Kerkesa per Rishqyrtim) nga OE: **GREEN INSTALL SH.P.K.**

NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit

53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe do të kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga të gjitha palët që kane marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet material janë te mëdha ne përgatitjen e këtij tenderi konkretisht KpR ne vlere: 450.00 Euro, Dëme tjera materiale te shkaktuar janë 10 punëtorë te angazhuar për këtë projekt mund te mbesin pa te ardhura, si dhe dëme tjera materiale janë 10% e fitimit te humbur nga ky projekt, sepse ne operojmë ne kete fushe te kësaj natyre te prokurimit dhe jemi profesional.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*